



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 03

Prishtinë, më 01 shkurt 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Adem Salihaj, Vladimir Todorović, dhe Kolë Berisha.

Munguan: Armend Zemaj dhe Mufera Şinik ishin në udhëtim zyrtar.

Pjesëmarrës të tjerë: Shqipe Arifaj - Asociacioni i Komunave të Kosovës, Lumnije Muarti – ZPRK, Jetulla Aliu – AKK, Visar Ramaj – KDI, Vlora Marmullakaj – EULEX, Mentor Borovci, Georgi Rupcher – EU-AC, Lendita Kastrati - EU-AC, Saranda Stublla – Lëvizja FOL dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 25 janarit 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mjekësinë ligjore,
4. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit lidhur me rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që ka të bëjë me fushëveprimin dhe me Rregulloren e brendshme të punës së Komisionit,
5. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore lidhur me Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtareve të lartë publikë,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 25 janari 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25 janar 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për mjekësinë ligjore

Kryetari - I njoftoi të pranishmit me përmbajtjen e Projektligjit, për të cilin tha se është i hartuar mirë. Do të ishte mirë ta formojmë një grup pune, që do të punonte në këtë projektligj. Edhe unë do të jem pjesë e këtij grupi.

Meqë nuk pati vërejtje u formua grupi i punës me këtë përbërje: Bahri Hyseni – kryetar, Ibrahim Makolli, Adem Salihaj, Selvije Halimi dhe Vladimir Todorović - anëtarë. Takimi i pare i grupit do të mbahet më 08. 02. 2010, në orën 10:00.

4. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit lidhur me rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që ka të bëjë me fushëveprimin dhe me Rregulloren e brendshme të punës të Komisionit

Kryetari - I njoftoi të pranishmit me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-181. Tha se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i ka hartuar përgjegjësitë, sepse nuk i ka të përcaktuara me Rregulloren e punës. Nga ne, si Komision, është kërkuar ta japim mendimin rreth përgjegjësiave të Komisionit. Tha se Rregullorja e punës të Kuvendit është në përfundim e sipër dhe nuk e di pse kanë kërkuar nga Komisioni për Legjislacion mendim rreth kësaj çështjeje. Lidhur me këtë pikë hapi debat.

Ibrahim Makolli - Theksoi se ishte i befasuar me këtë përfundim të Kryesisë, sepse nuk mund të kërkohej nga një komision t'i shqyrtonte rekomandimet për punën e një komisioni tjetër, sepse komisionet janë të barabarta. Është ky Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit, i cili e ka përcaktuar fushëveprimin e komisioneve të tjera. Konsideroi se është e tepërt të kërkohej nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ta shqyrtojë rekomandimin për fushëveprimin e komisionit tjetër.

Kryetari - Sqaroi se me këtë rekomandim është kërkuar nga Komisioni për Legjislacion të shikojë që përgjegjësitë e përcaktuara të mos bien ndesh me kompetencat e komisioneve të tjera. Pasi Komisioni për Mandate dhe rregullore është duke e përfunduar punën rreth hartimit të Rregullores së punës të Kuvendit, atëherë do të mbajë kontakt me kryetarin e këtij Komisioni, që t'i harmonizojmë qëndrimet rreth kësaj çështjeje.

Adem Salihaj – Vuri në pah se duhet të shikohet Rregullorja e punës e Kuvendit se a kemi të drejtë si Komision të ndërhyjmë në çështjet e komisioneve të tjera. Konsideroi se nuk kemi bazë juridike të ndërhyjmë në këtë çështje.

Selvije Halimi tha se çdo dokument që dërgohet në Kuvend duhet të kalojë nëpërmes Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Meqë ky komision është krijuar tani, përvojat e vendeve që janë sugjeruar të merren për krijimin e këtij Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike janë të ndryshme. Fakti që disa anëtarë janë pjesë edhe e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike edhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa në disa vende kjo lejohet e në disa jo. Konsideroi që në si Komision duhet të shikojmë vetëm bazën juridike edhe jo të lëshohemi në çështjet tjera.

Pas një diskutimi, Komisioni, vlerësoi se pasi Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit, t'i përfundojë qëndrimet rreth kësaj çështjeje, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do t'i harmonizojë qëndrimet me këtë Komision.

Kundër këtij propozimi ishin Ibrahim Makolli dhe Adem Salihaj.

Adem Salihaj e ndau mendimin, sepse kjo, sipas tij, nuk ishte kompetencë e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

5. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore lidhur me Projektligjin për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtareve të lartë publikë

Kryetari - Tha se në takimin me kryetarin e Kuvendit e kam ngritur shqetësimin, sepse në si Komision po arrijmë ta përfundojmë shqyrtimin e projektligjeve brenda afatit të paraparë, ndërsa për çështje krejt formale projektligjet bllokohen në komisionet tjera.

Meqë nuk pati vërejtje Projektligji për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtareve të lartë publik, procedohet për shqyrtim të mëtejshëm.

6. Të ndryshme

-Shqyrtimi i bazës juridike të projektligjeve

Adem Salihaj - Tha se do të ishte mirë të vendoset para se të shkojë në Kuvend, në mënyrë që të mos debatohet kjo çështje dhe pasi të vijë në Komision të themi se nuk ka bazë juridike.

Meqë nuk pati vërejtje të tjera Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të projektligjeve:

Projektligji për Kryqin e Kuq të Kosovës,
Projektligji për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq dhe të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve,
Projektligji për produktet dhe pajisjet medicinale,
Projektligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare,
Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe mbikëqyrjen inspektuese,

Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe
Projektligji për energjinë dhe Projektligji i Rregullatorit të Energjisë

Komisioni vlerësoi se projektligjet kanë bazë juridike në pajtim me nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

b. Njoftim rreth buxhetit të Komisionit për vitin 2010

Kryetari - I njoftoi të pranishmit rreth buxhetit që i është ndarë Komisionit për këtë vit në vlerë 20 mijë euro, të cilat mund të shfrytëzohen nga komisionet parlamentare për vizita brenda vendit, për dëgjime publike dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Mirëpo, nëse Komisioni vendos për angazhimin e ekspertëve, ata duhet të jenë nga lista e *data bazës*. Nëse Komisioni vendos për angazhimin e ekspertëve jashtë listës, duhet t'i nënshtrohet procedurës së tenderimit. Kjo do të thotë se asnjë ligj nuk do të mund ta përfundonim për shkak të kohës. Unë do të reagoj, sepse kjo procedurë e tenderimit është e papërshtatshme edhe ia pamundëson Komisionit që me kohë t'i procedojë projektligjet.

Selvije Halimi - Tha se si Komision, edhe po të kishim mundësi që me kohë të marrim ekspertë për fushat përkatëse, prapë do të ishte e pamundur, sepse nuk kemi mundësi ta formojmë një Komision vlerësues, që do t'i vlerësojë kandidatët për fushat përkatëse, sepse Kuvendi nuk ka kapacitet t'i vlerësojë kandidatët.

Adem Salihaj - Tha se me këto proceduar shihet se nuk do të kemi mundësi që këto mjete t'i shpenzojmë aty ku nevojitet, si për vizita jashtë vendit, për t'u njohur me përvojat e vendeve të tjera. Kështu puna e Komisionit do të mbetet e mangët. Do të ishte mirë sikur kjo çështje të përcillej në Kryesinë e Kuvendit dhe ndoshta të kërkohej edhe debat në Kuvend.

Bajram Kosumi – E mori shembull, si realizohen këto mjete nëpërmjet tenderit, me agjencitë që ofrojnë shërbime juridike, në vendet e ndryshme. Edhe Kuvendi do të duhej të hapte tender publik për konsulencë juridike, që të ketë marrëveshje më ndonjë agjenci. Në momentin kur nevojiten ekspertë të fushave përkatëse, agjencia është e detyruar t'ia ofrojë Komisionit. Kështu do të duhej të ishte praktika më e mirë, sepse me këto procedura, siç parashihen këtu, kjo është e pamundur të realizohet.

Kryetari - Në fund tha se e merr për obligim të bisedojë me kryetarin e Kuvendit lidhur me këtë çështje, sepse kjo procedurë është e papranueshme dhe ia pamundëson Komisionit shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20

Përgatiti:
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni